

SILABUS i lëndës

Shqipja e shkruar

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë- Dega e Letërsisë
Titulli i lëndës:	Shqipja e shkruar
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	E obliguar
Viti i studimeve:	Viti I Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	E mërkurë, ora 14:30- 16:00 Salla 78
Mësimdhënësja e lëndës:	Prof. Ass. Dr. Flutura Çitaku
Detajet kontaktuese:	Tel: 045 420 876 E-mail: flutura.citaku@gmail.com . Këshillimet me studentë: e hënë:13:00-14:00, e enjte:15:00-16:00, Zyra nr.72-F. i Filologjisë
Përshkrimi i lëndës	<p>Studentët do të njihen me konceptin dhe termin Gjuhë standarde dhe faktorët e përvetësimit të tij, qofshin ata gjuhësorë apo jashtëgjuhësorë. Është e nevojshme që të njihen me piramidën gjuhësore të gjuhës shqipe në bazën e së cilës qëndron të folurit e individëve, pak më lart janë të folmet e qyteteve, të fshatrave, pastaj më lart të folmet krahinore, nëndialektet, dialektet dhe në majë të piramidës qëndron gjuha standarde, përmes së cilës komunikojnë të gjithë shqiptarët në situata formale. Studentët do të njihen me parimet themelore të drejtshkrimit të shqipes si dhe normat e shqipes standarde, fillimisht me normën gramatikore, për të vazhduar me atë sintaksore dhe leksikore. Çështjet e drejtshkrimit do të trajtojnë përdorimin e zanoreve. Vëmendje e veçantë do t i kushtohet përdorimit të ë-së fundore. Gjithashtu përdorimi i apostrofit paraqet një problem për drejtshkrimin e gjuhës shqipe.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Përvetësimi i lëndës dhe aftësimi i studentëve për ta zbatuar atë edhe praktikisht. Kjo nënkupton përdorimin e shqipes standarde në situatat formale. Përvetësimi i rregullave të drejtshkrimit. Formimi i shprehive për të shkruar drejt. Përvetësimi i rregullave themelore të drejtshqiptimit.</p>

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të flasin dhe të shkruajnë rrjedhshëm gjuhën standarde shqipe. • Të vetëdijësohen që standardi duhet përdorur në situata formale. • Të aftësohen për ta dalluar variantin standard nga ai jostandard-dialektor, sidomos gjatë ligjërimit të folur. • Të përdorin gjatë ligjërimit fjalën shqipe në vend të fjalës së huaj., sidomos ta përdorin terminologjinë e fushës përkatëse me sa më pak dzsorë. Kjo do të thotë që edhe në terminologji fjala shqipe duhet të ketë përparësi karshi fjalës (termit të huaj).
---	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2(90 min.)	15	22.5
Ushtrime teorike/laboratorike	1(45 min.)	15	11
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2.5
Ushtrime në teren			
Kollokuime,seminare	10min.	15	2.5
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	22.5
Përgatitja përfundimtare për provim	2	25	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet ,etj	30 min.	1	0.5
Totali			102.5:25=4.1
4 ETCS			

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>ligjërata, ushtrime, detyra shtëpie, debate për çështje të ndryshme lidhur me drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin; hartimi i një fjalorthi bashkë me studentët me titull: “fjala shqipe në vend të fjalës së huaj”, ku do të përfshihen fjalët e huaja të panevojshme që po përdoren sot kudo. përballë këtyre fjalëve do të jepen gjegjëset e tyre në shqip. puna rreth këtij fjalorthi do të vazhdojë gjatë tërë semestrit dhe do të jetë detyrë e përhershme e</p>
-------------------------------------	--

	studentëve për të sjellë sa më shumë fjalë. studentët gjithashtu do të kenë për detyrë të ndjekin përdorimin e standardit në madiat e shkruara dhe të folura: radio e tv si dhe bie fjala në parlament..mund të ndiqet ndonjë shfaqje , mund të vështrohet përdorimi i standardit në përkthimet e filmave etj. mund të japin sugjerime lidhur me gjuhën e teksteve që i përdorin ata.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 15% Vlerësimi i dytë: 15 % Detyrat dhe punimet e seminareve: 10 % Vijimi i rregullt: 5 % Provimi final 55 % Gjithsej: 100 % Provimi mbahet me test dhe plotësohet edhe me gojë.
Literatura	
Literatura bazë:	
Literatura plotësuese:	Rami Memushaj, Shqipja standarde- si ta flasim e ta shkruajmë, Tiranë 2014 ASHRSH; Për pastërtinë e gjuhës shqipe, Tiranë, 1998. Gjovalin Shkurtaj, Si të shkruajmë shqip, Tiranë , 2008 IAP, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 1974 ASHRSH, Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1976 A. Dhrimo, R. Memushaj, Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2011 Fjalorë të gjuhës shqipe (1980, 1984, 2002, 2006) Revistat: Studime filologjike dhe Gjuha jonë (Tiranë); Gjurmime albanologjike, Gjuha shqipe, Filologji (Prishtinë), etj. Vepra letrare, fragmentet e të cilave do të përdoren për ushtrime Të dhëna nga interneti
Plani i disejnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Koncepti dhe termi Gjuhë standarde
Java e dytë:	Gjuha standarde dhe dialektet
Java e tretë:	Normat dhe parimet e drejtshkrimit të shqipes standarde

Java e katërt:	Norma gramatikore: gjinia, trajta dhe rasa e emrit.
Java e pestë:	Shumësi i emrave-formimi i shumësit dhe çështje drejtshkrimore
Java e gjashtë:	Llojet e përemrave. Përemrat vetorë-lakimi i tyre. Trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara-përdorimi i drejtë i tyre.
Java e shtatë:	Folja-çështje që lidhen me drejtshkrimin e tyre-pjesorja e foljeve
Java e tetë:	Vlerësim i parë i njohurive.
Java e nëntë:	Drejtshkrimi i zanoreve-ë-ja fundore te foljet
Java e dhjetë:	Ë-ja fundore te emrat dhe te pjesët e tjera të ligjëratës
Java e njëmbëdhjetë:	Norma leksikore: fjala shqipe në vend të fjalës së huaj
Java e dymbëdhjetë:	Apostrofi
Java e trembëdhjetë:	Përdorimi dhe drejtshkrimi i nyjës së përparme Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes
Java e katërbëdhjetë:	Vlerësimi II i njohurive
Java e pesëmbëdhjetë:	Përdorimi i shkronjës së madhe dhe i shenjave të pikësimit

Vlerësimi i parë intermediar (test provues)-java e tetë, 19 nëntor 2015

Vlerësimi i dytë intermediar (test provues)-java e pesëmbëdhjetë-7 janar 2016

Shënim: Të dy testet provuese do të mbahen jashtë orarit të mësimit ose në orët e ushtrimeve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt i studentëve në ligjërata, përmbushja e detyrimeve sipas kritereve të mbarëvajtjes së procesit mësimor etj.